



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1387 Prot
Shkodër, më 30.01.2023



SHKODËR

Nr. 4 Prot
Shkodër, më 30.01.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

"Për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet"

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë 30/01/2023 ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

1. **Bashkia Shkodër** me kryetar **Z. Bardh SPAHIA**, perfaqësuar nga zv /Kryetari z.Tonin Dedaj sipas vendimit delegimit nr.28 dt.25.01.2023, me adresë Rr. "13 Dhjetori", këtej e tutje e cilësuar si Bashkia;
2. **Shoqata "Consulting and Development Partners (CODE Partners) Shkodër"** e regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr 3380/3 date 23.07.2018, Çertifikatë Regjistrimi me nr identifikimi (NIPT/SSN) L2700219W, përfaqësuar nga **Znj. Arta Nikolli**, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. H75407120W, në cilësinë e Drejtor, Zbatues i projektit me adresë në Rr. Palok Kurti" Nr. 1, Shkodër.

Dhe punë kërkuesve :

1. Perparim Narkaj, adresa e të cilit është Lagjja nr.3 Shkodër,
2. Drande Narkaj, adresa e së cilës është Lagjja nr.3 Shkodër,
3. Sema Nutaj, adresa e së cilës është Lagjja nr.3 Shkodër,
4. Arben Kola, adresa e të cilit është Lagjja nr.5 Shkodër,
5. Gjokë Dacaj, adresa e të cilit është Lagjja nr.5 Shkodër,
6. Pjerin Hanxhari, adresa e të cilit është Lagjja nr.4 Shkodër,
7. Shevqet Dibra, adresa e të cilit është Lagjja nr.1 Shkodër,
8. Astrit Zaganjori, adresa e të cilit është Lagjja nr.1 Shkodër,
9. Ali Puka, adresa e të cilit është Lagjja nr.1 Shkodër,
10. Arif Papaj, adresa e të cilit është Lagjja nr.1 Shkodër,
11. Nazire Papaj, adresa e së cilës është Lagjja nr.1 Shkodër,
12. Kujtim Terfoja, adresa e të cilit është është Lagjja nr.1 Shkodër,

13. Aleksander Dedushi, adresa e të cilit është Lagjja nr.3 Shkodër,
14. Aleks Koçeku, adresa e të cilit është Lagjja nr.3 Shkodër.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar;
- Ligjit nr. 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punës" i Republikës së Shqipërisë të ndryshuar;
- Vendimi i të Këshillit të Ministrave Nr.535, datë 08.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet".

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshjeje është : "**Zbatimi i programit të punëve publike në komunitet**" sipas tabelës bashkëlidhur.

Neni 2 Kohëzgjatja

- 2.1 Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje është 12 muaj që nga data e fillimit të punësimit referuar programit sipas VKM Nr.535, datë 08.07.2020. Kontrata do të ndërpritet automatikisht pasi plotësohet kohëzgjatja prej 12 muajsh dhe nuk mund të zgjatet me të njëjtin pjesëmarrës.
- 2.2 Efektet financiare fillojnë me datë 24.11.2022.

Neni 3 Qëllimi

- 3.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi ofron kornizën për një marrëdhënie midis palëve me qëllim të zbatimit të programit të punëve publike në komunitet, sipas kriterëve dhe përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.535, datë 08.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet" dhe Rregullores Nr.1, datë 16.08.2021, të konsultuar e aprovuar nga Këshilli Konsultativ i Punësimit në mbledhjen e datës 22.07.2021.
- 3.2 Qëllimi i programit të punëve publike në komunitet është të krijojë mundësi punësimi për përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuësve të papunë afatgjatë, nëpërmjet mundësive të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.
- 3.3 Përfituesi dhe zbatuesi i projektit CODE Partners vë në dispozicion të bashkisë Shkodër, për nevojat e saj dhe punët në komunitet, grupin e punëmarrësve sipas listës më siper.
- 3.4 Bashkia Shkodër bashkë me CODE Partners, cakton vendin e punës për secilin nga

punëmarrësit duke siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm pune gjatë gjithë periudhës së punësimit dhe trajnimit, sipas legjislacionit në fuqi.



Neni 4 **Monitorimi**

- 4.1 Monitorimi do të bëhet në mënyrë të rregullt nga specialistët e drejtorisë Ekonomike të Arsimit pranë bashkisë Shkodër dhe CODE Partners. Gjatë monitorimit specialisti mund të zhvillojë biseda individuale me të Punësuarin.
- 4.2 Nëse punëkërkesit e papunë të punësuar nuk do të jenë të pranishëm gjatë dy vizitave të njëpasnjëshme monitoruese apo nëse paraqiten problematika të tjera të vërtetuara, CODE Partners, Bashkia Shkodër dhe Zyra e Punesimit rezervojnë të drejtën për të rekomanduar ndërprerjen e marrëveshjes me palën përkatëse me penalitet përkatëse.

Neni 5 **Gjuha e marrëveshjes**


- 5.1 Gjuha e marrëveshjes është gjuha Shqipe.

Neni 6 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 6.1 Çdo palë ka të drejtë të përfundojë marrëveshjen me një njoftim paraprak prej 5 (pesë) ditë pune.
- 6.2 Palët do të përpiqen për të zgjidhur mosmarrëveshjet me mirëkuptim për çështjet që mund të lindin ndërmjet tyre në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 6.3 Në rast se zgjidhja me mirëkuptim nuk arrihet brenda periudhës së caktuar, mosmarrëveshja do të zgjidhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 6.4 Kjo marrëveshje hartohet në katër (4) kopje origjinale, e cila pasi u lexua nga palët, u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

PËR
BASHKINË SHKODËR
KRYETAR

Bardh SPAHIA
me vendim delegimi
z. Tonin Dëdaj




PËR
Consulting and Development Partners

Drejtor

Arta NIKOLLI



Tabelë 1



Nr.	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Pozicioni i punës	Paga mujore bruto (lekë)	Data e Marrëveshjes		Kohëzgjatja e subvencionimit 12 muaj
				Fillimi	Përfundimi	
1.	Perparim Narkaj	Pastrues terreni	17000	24/11/22	23/11/23	12
2.	Drande Narkaj	Pastrues terreni	17000	24/11/22	23/11/23	12
3.	Sema Nutaj	Pastrues terreni	17000	24/11/22	23/11/23	12
4.	Arben Kola	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
5.	Gjoke Dacaj	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
6.	Pjerin Hanxhari	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
7.	Shefqet Dibra	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
8.	Astrit Zaganjori	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
9.	Ali Puka	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
10.	Arif Papaj	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
11.	Nazire Papaj	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
12.	Kujtim Terforja	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
13.	Aleksander Dedushi	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12
14.	Aleks Koceku	Puntore pastrimi	17000	24/11/22	23/11/23	12